




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-514/2013
Nr. lfaq. Broj stranica 03	Data Datum 20-02-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.01.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3915/12, Lidhur me themelimin e Komisionit Qeveritarë për Hartimin dhe Finalizimin e Koncept- Dokumentit për Regjistrin e Mërgimtareve, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të Interesit në emërimin e njërës nga anëtarët e këtij komisioni, z.Lulzim Dragusha, Këshilltar në Ministrinë e Diasporës.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqitën rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të Interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-3915/12, që për trajtim ka pasur vendimin për themelimin e Komisionit Qeveritarë për Hartimin dhe Finalizimin e Koncept-Dokumentit për Regjistrin e Mërgimtareve. Ku është dyshuar se mund të ketë gjendje të konfliktit të Interesit në emërimin e njërës nga zyrtarët të propozuar nga Ministria e Diasporës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes si dhe pas takimeve me përfaqësuesit kompetent të institucionit që ka propozuar emrat e këtij komisioni është konstatuar se procesi për themelimin e Komisionit Qeveritar për hartimin dhe Finalizimin e Koncept- Dokumentit për Regjistrin e Mërgimtareve, ka filluar duke u bazuar në neni 4 paragrafi 1.7 të ligjit Nr.04/L.095 për Diasporën dhe Mërgatën.

Bazuar në këtë, Ministria e Diasporës është institucioni i mandatar që në bashkëpunim me institucionet tjera kompetente, të përpiloj regjistrin e mërgimtareve.

Gjatë hetimeve lidhur me procesin, jemi informuar se Ministria e Diasporës ka zhvilluar një proces lidhur me këtë çështje, duke organizuar takime konsultative me institucionet relevante që duhet të përfshihen në këtë proces, për të shqyrtuar modalitetet lidhur me organizimin e këtij procesi. Si rezultat i këtyre takimeve, ka dalë ideja se duhet të formohet një komision Qeveritarë i cili do të ishte kompetent që sipas nenit 29 të Rregullores së Punës së Qeverisë, të hartoj dhe propozoj, për shqyrtim dhe aprovim në Qeveri, një koncept dokument, më të cilën do të shqyrtoheshin disa opsione për realizimin e procesit të hartimit të regjistrin të mërgimtarëve.

Pas takimit të nivelit të ekspertëve të institucioneve përkatëse dhe bazuar në rregulloren e punës së Qeverisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Diasporës, i ka propozuar Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, që të përfshihet për shqyrtim dhe aprovim në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Qeverisë, Propozimi-Vendimi për themelimin e Komisionit Qeveritar për Hartimin dhe Finalizimin e Koncept- Dokumentit për Regjistrin e Mërgimtareve, në të cilën propozim janë propozuar emrat e përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në këtë proces, nisur nga rezultatet e takimeve dhe në bashkëpunim me institucionet e përfshira.

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Diasporës, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 24 tetor 2012, mori Vendim për themelimin e Komisionit Qeveritar për hartimin dhe finalizimin e Koncept- Dokumentit për regjistrin e mërgimtarëve.

Gjatë analizës dhe hetimit të procesit dhe fakteve të ofruara në dispozicion konstatohet se: nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e konfliktit të Interesit në procesin e emërimit të anëtareve të Komisionit Qeveritar për Hartimin dhe Finalizimin e Koncept- Dokumentit për Regjistrin e Mërgimtareve, konkretisht me Kryesuesin e këtij komisioni, z.Lulzim Dragusha, Këshilltar i Ministrit të Diasporës, i cili sipas detyrës zyrtare dhe me propozim nga kjo ministri është propozuar në këtë komision, ai është i përfolur nga informata se ka lidhje familjare me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaqi, dhe është aluduar në konflikt të Interesit, mirëpo konsiderojmë se roli i pozitës së Kryesuesit në këtë komision nuk është rol ekzekutiv dhe nuk ka asnjë lidhje të Interesit financiar, apo personal pasuror, pasi këto komisione për punën e tyre nuk kanë asnjë përfitim financiar dhe roli i tyre është i rregulluar me legjislacionin në fuqi, si dhe i tërë procesi është i bazuar sipas nenit 29 të Rregullores së punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Nga e tërë kjo konstatohet se në bazë të të gjeturave dhe fakteve si dhe në bazë të vlefshmërisë së vendimit gjithëpërfshirës të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës e të nënshkruar nga Kryeministri i Kosovës nuk ka elementë që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqitën rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)